



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2397 Prot.

Tiranë, më 30.09.2025

VENDIM

Nr. 291, datë 24.09.2025

**“PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM SHKODËR”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.09.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2397 prot., datë 23.09.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me relator znj. Ledina Riza, si dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efijencës.
2. Me Vendimin nr. 311, datë 04.10.2021, *“Për caktimin e z. Albert Murçaj, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”*, Këshilli ka caktuar prokurorin Albert Murçaj në detyrën e drejtuesit në këtë zyrë prokurorie për periudhën 04.10.2021-03.10.2024.
3. Me Shkresën nr. 982 prot., datë 04.04.2024, prokurori Albert Murçaj ka paraqitur kërkesën për rikandidim në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, bazuar në nenin 52, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar *(në vijim Ligji për Statusin)*.
4. Në zbatim të nenit 52, pika 3, të Ligjit për Statusin, të Rregullores *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”*, e ndryshuar, si dhe Rregullores *“Për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”*, kur drejtuesi i një zyrë prokurorie kandidon për riemërim, ai i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës nga ana e Këshillit.

Për rrjedhojë, me Vendimin nr. 57, datë 25.04.2024, Këshilli ka filluar procedurën për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në zyrën e Prokurorisë Shkodër, prokurorin Albert Murçaj, si dhe ka caktuar me short relatorin për këtë procedurë.
5. Kjo procedurë ka përfunduar me Vendimin nr. 264, datë 12.12.2024, *“Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Albert Murçaj, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”*, sipas të cilit, prokurori Albert Murçaj ka kaluar me sukses procesin në fjalë.
6. Nga ana tjetër, procedura e vlerësimit etik dhe profesional (sipas Vendimit nr. 406, datë 28.12.2023, *“Për caktimin me short të prokurorëve për të cilët do të kryhet vlerësimi etik*

dhe profesional përgjatë vitit 2024, të relatorit dhe këshilltarit ligjor përgjegjës për procedurën e vlerësimit” të Këshillit), bazuar në Rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm” për prokurorin Albert Murçaj, që ka rikandiduar për një mandat të dytë në pozicionin e drejtuesit është ende në vijim.

Siç dihet, procesi për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve është proces kompleks që kërkon një kohë të caktuar për realizimin e tij.

7. Përpara plotësimit të afatit dhe mandatit ligjor si drejtues në zyrën e Prokurorisë Shkodër në datën 03.10.2024, prokurori Albert Murçaj është caktuar përkohësisht të ushtrojë të njëjtën detyrë për një periudhë deri në 3 (tre) muaj, fillimisht me Vendimin nr. 206, datë 30.09.2024¹, të Këshillit, me Vendimin nr. 269, datë 23.12.2024 dhe më pas me Vendimin nr. 47, datë 20.03.2025.
8. Së fundi, me Vendimin nr. 116, datë 23.06.2025, “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”, të Këshillit, prokurori Albert Murçaj është caktuar të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për një periudhë deri në tre muaj.
9. Sipas vendimeve të mësipërme, ushtrimi i detyrës së drejtuesit për disa periudha tre mujore llogaritet nga data 03.10.2024 që është edhe data e plotësimit të mandatit 3 (tre) vjeçar si drejtues të prokurorit Albert Murçaj.
10. Duke analizuar rrethanat e mësipërme vlerësohet i nevojshëm vazhdimi i caktimit përkohësisht të prokurorit Albert Murçaj në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për një periudhë deri në tre muaj.
11. Ky caktim i përkohshëm mund të ndërpritet në çdo moment nëse Këshilli vendos riemërimin e tij si drejtues në këtë zyrë prokurorie për një mandat tjetër tre vjeçar.
12. Përsa i takon bazës ligjore, në Nenin 59, të Ligjit për Statusin, parashikohet se:
“1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:
a) caktimit në pozicione të tjera,
b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.”

¹ https://klp.al/wp-content/uploads/2024/10/v.nr_.206.pdf

13. Ndërsa, në nenin 3, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, "Për miratimin e Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", e ndryshuar, të Këshillit, përcaktohet se:

"1. Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm."

14. Caktimi i përkohshëm i prokurorit Albert Murçaj, në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për një periudhë të re deri në 3 (tre) muaj siguron në vazhdimësi funksionimin normal dhe mbarëvajtjen e punës në këtë zyrë prokurorie.

15. Duke vlerësuar se rrethanat e mësipërme për caktimin e përkohshëm të drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar caktimin përkohësisht të prokurorit Albert Murçaj që të ushtrojë funksionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për një periudhë deri në tre muaj.

16. Për këtë periudhë, prokurori Albert Murçaj do të përfitojë pagën e drejtuesit të zyrës së prokurorisë, sipas ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës, në nenin 59, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 184, 189 pika 1, germa "a" të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, si dhe nenin 3, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, "Për miratimin e Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e përkohshëm të prokurorit Albert Murçaj në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për një periudhë deri në tre muaj.

2. Për periudhën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, prokurori Albert Murçaj të paguhet me pagën e pozicionit ku është caktuar përkohësisht.

3. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe prokurori Albert Murçaj.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 24.09.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla